BalkanWeb | GAZETA SHQIPTARE

Atentati në Shkodër, autorët zbrazën katër karikatorë dhe 106 plumba mbi efektivin Gjergj Ndërshtiqaj dhe kunatin e tij, ja çfarë treguan kamerat e sigurisë

Senad Nikshiqi | 15 Mars, 2024 08:26

Madhësia e tekstit:

Disa detaje të reja kanë dalë nga plagosja e efektivit të policisë Gjergj Ndërshtiqaj në Shkodër dhe kunatit të tij Gjon Nika mbrëmjen e kaluar. Dy të plagosurit ndodhen jashtë rrezikut për jetën në spitalin e Shkodrës ndërsa secili kanë marrë nga dy plumba në trup. Të dëmtuarit janë qëlluar me 106 plumba, mbi katër karikatorë automatiku por duke shpëtuar mrekullisht. Pas ngjarjes së rëndë tre automatikë kallashnikov janë gjetur në automjetin e djegur të autorëve ndërsa janë sekuestruar nga policia si provë materiale. Dy prej automatikëve që janë përdorur u gjetën në sedilen e përparme ndërsa arma e tretë automatik është gjetur në bagazh dhe mendohet se ishte rezervë. Po ashtu autorët dyshohet se kanë qenë të maskuar ndërsa nga pamjet e kamerave të sigurisë është e paqartë nëse kanë qëlluar pasi kanë dalë nga makina e tyre apo nga brenda makinës. Nga kamerat nuk është arritur të bëhet identifikimi për shkak se autorët nuk dalin në pamje.

Ndërkohë polici Gjergj Ndërshtiqaj ka patur armën e shërbimit me vete, por nuk e ka përdorur pasi nuk ka arritur që të kundërpërgjigjet.

Të plagosurit janë qëlluar sapo kanë dalë nga makina e tyre e cila nga plumbat e shumtë morí flakë. Në momentin që ka nisur breshëria e plumbave polici dhe kunati i tij janë fshehur pas automjetit të tyre ndërsa i treti që nuk u plagos ka arritur që të largohet në një fushë aty afër duke humbur mes errësirës. Autorët me një automjet fouristradë pa targa dyshohet se i kanë ndjekur të plagosurit nga mbrapa dhe këta të fundit pasi janë ndalur në afërsi të një lokali menjëherë i kanë qëlluar.

Të dëmtuarit janë shprehur pasi janë marrë në pyetje se nuk kanë arritur që të shohin se kush ishin autorët. "Sapo zbritëm nga makina dëgjuam të shtëna armësh. Nuk kemi arritur që të shohim se kush ishin ata që na qëlluan me armë. Nuk kemi konflikte me persona të tjerë dhe nuk e dimë arsyen përse na qëlluan. Në momentin kur nisën të shtëna kemi lëvizur me shpejtësi duke u munduar të shpëtojmë. Derisa janë larguar qëndruam pas makinës".

Sponsored Links

Sipas burimeve policore objektivi ka qenë shtetasi Gjon Nika. Ndërkohë në Shkodër menjëherë pas kësaj ngjarje të rëndë mbërriti drejtori i përgjithshëm i policisë së shtetit Muhamet Rrumbullaku duke qenë në krye të hetimeve. Është ende e paqartë se cili është motivi i kësaj ngjarje të rëndë. Policia ka shoqëruar disa persona por pa arritur ende tek autorët e dyshuar.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Gjergj Ndërshtiqaj

TË NGJASHME

U përdorën tre kallashnikovë, detaje të tjera nga atentati në Shkodër. Si reagoan të plagosurit në momentin e të shtënave, duke arritur të...

12 Mars, 2024

Taboola Feed

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

"Tij pyeten përmes letërporosive", dëshmia e 5 shtetasve amerikanë përpilas prokurorët e SPAK me avokatët e Medlut

15 Mars, 2024

"Më mori në telefon ministri i Mbrojtjes dhe..." / Seanca për "Gërdecin", ish-drejtori i Logjistikës refuzon të japë dëshminë

13 Mars, 2024

'Gërdec'/ A do të pranojë të dëshmojë? Ja çfarë ka vendosur ish-ministri Mediu

15 Mars, 2024

S'i pëlqeu mishi në hell dhe plagosi kuzhinierin shqiptar, del para gjykatës 52-vjeçari

13 Mars, 2024

U arrestua ditën e djeshme në Dubai, deportohet sot në Shqipëri Bruno Çobo

15 Mars, 2024

EMRU/Përpunonte lëndë narkotike në banesë duke e ndarë në doza, arrestohet 53-vjeçari në Durrës

15 Mars, 2024

KATEGORIA VIDEO

Një ditë pas dakordësisë në Konferencën e Kryetarëve, Bardhi mbledh set grupin parlamentar, Basha pritet të përjashtojë...

13 Mars, 2024

Droni izraelit godet makinën jashtë kampit në Liban, dy pasagjerë të vdekur

13 Mars, 2024

Atentati në Shkodër, autorët zbrazën katër karikatorë dhe 106 plumba mbi efektivin Gjergj Ndërshtiqaj dhe kunatin e tij, ja çfarë treguan kamerat e sigurisë

Senad Nikshiqi | 15 Mars, 2024

Pamjet e frikshme/ Shpërthim në një restorant në Kinë, 1 i vdekur, 22 të plagosur

13 Mars, 2024

A do të ketë një kthesë tronditëse? Shifrat në favor të Trump, i vetëm përballë Biden për garën presidenciale

13 Mars, 2024

VIDEO/ Barcelona tregon forcën në Champion, katalanasit në çerekfinale, Arsenali i falet penalltive

12 Mars, 2024

BW | Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Një ditë pas dakordësisë në Konferencën e Kryetarëve, Bardhi mbledh set grupin parlamentar, Basha pritet të përjashtojë...

13 Mars, 2024

Droni izraelit godet makinën jashtë kampit në Liban, dy pasagjerë të vdekur

13 Mars, 2024

Atentati në Shkodër, autorët zbrazën katër karikatorë dhe 106 plumba mbi efektivin Gjergj Ndërshtiqaj dhe kunatin e tij, ja çfarë treguan kamerat e sigurisë

Senad Nikshiqi | 15 Mars, 2024

Pamjet e frikshme/ Shpërthim në një restorant në Kinë, 1 i vdekur, 22 të plagosur

13 Mars, 2024

A do të ketë një kthesë tronditëse? Shifrat në favor të Trump, i vetëm përballë Biden për garën presidenciale

13 Mars, 2024

VIDEO/ Barcelona tregon forcën në Champion, katalanasit në çerekfinale, Arsenali i falet penalltive

12 Mars, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.